

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dales / Izlaze: Date / Dana: 05 / 08 / 2026		
Nr. Origj. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 216	Nr. Faqeve. Br. Strana. 16
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbali i përgjithshëm i dëgjimeve buxhetore të organizuara gjatë vitit 2026 për buxhetin e vitit 2027 dhe planifikimet për vitet 2028/2029

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me kryetar/e të këshillave të lagjeve dhe fshatrave

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për vetëqeverisjen lokale, transparencën publike dhe menaxhimin e financave publike, si dhe në funksion të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, u mbajt dëgjimi publik për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2028-2029. Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit mbi orientimet kryesore buxhetore të komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në funksion të planifikimit sa më transparent, efikas dhe gjithëpërfshirës të buxhetit komunal dhe dokumenteve strategjike financiare.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe pasqyrimin të kontributit të qytetarëve përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë këtij dëgjimi, duke shërbyer njëkohësisht si mjet zyrtar i transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike. Dokumentimi i këtij procesi synon të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit të evidentohen dhe të trajtohen në mënyrë të duhur gjatë fazës së përgatitjes së draft-buxhetit final dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028-2029.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Dëgjimi publik u mbajt në kuadër të angazhimeve të Komunës së Ferizajt për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor dhe për forcimin e transparencës institucionale, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit. Përmes këtij procesi u synua identifikimi i prioritetëve zhvillimore të qytetarëve në fusha të ndryshme si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal, me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit.

Më 27 korrik 2026 u mbajt dëgjimi i parë buxhetor me kryetarët e këshillave të lagjeve dhe fshatrave të Komunës së Ferizajt, në kuadër të procesit të hartimit të Projektbuxhetit Komunal për vitin 2027.

Takimin e hapi drejtoresha e Financave, znj. Sebahate Ajeti-Sadiku, e cila theksoi rëndësinë e këtyre dëgjimeve publike, duke i cilësuar ato si mekanizma të domosdoshëm për identifikimin dhe trajtimin e nevojave dhe problemeve me të cilat përballen qytetarët e Komunës së Ferizajt.

"Këto takime kanë rëndësi të madhe, pasi në to diskutohen dhe trajtohen tema të ndryshme, me qëllim që të gjenden zgjidhje për problemet e qytetarëve. Kontributi juaj është i domosdoshëm për ndërtimin e një infrastrukture më të mirë dhe më cilësore për të gjithë qytetarët", u shpreh drejtoresha Ajeti-Sadiku.

Pas fjalës hyrëse të drejtoreshës, fjala iu dha të pranishmëve për paraqitjen e kërkesave dhe prioritetëve të tyre.

Kërkesat e fshatit Sojevë

Kryetari i fshatit, Betim Sylja, paraqiti këto kërkesa:

- Asfaltimi i plotë i rrugës "Lisi i Rakitës".
- Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik dhe ndriçimi i plotë i fshatit në të gjitha lagjet.
- Asfaltimi dhe rehabilitimi i rrugëve të fshatit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Zgjidhja e problemit të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Ndërtimi i trotuareve përgjatë rrugëve kryesore për rritjen e sigurisë së këmbësorëve.
- Rregullimi i kanaleve kulluese dhe drenazhimi i tokave bujqësore.
- Shtrimi me zhavorr dhe mirëmbajtja e rrugëve bujqësore.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike dhe skajeve të rrugëve.
- Ndërtimi i një parku dhe këndi të lojërave për fëmijë.
- Investime në SHFMU "Ramadan Rexhepi" me pajisje moderne dhe përmirësim të infrastrukturës.
- Vendosja e kamerave të sigurisë në objektet publike dhe në shkollë.
- Mbështetje më e madhe për bujqit dhe zhvillimin e bujqësisë.
- Mbështetje për të rinjtë, sportin, kulturën dhe aktivitetet rinore.

Kërkesat e fshatit Gaçkë

Ilir Shabani paraqiti këto kërkesa prioritare:

- Rikonstruimi i rrugës kryesore me ndërtimin e trotuarit dhe asfaltim.
- Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Lagjen "Bajram Curri".
- Asfaltimi i rrugicave të fshatit.
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse.
- Rifunksionalizimi i ujësjellësit, riparimi i valvulave të gypave të ujit dhe renovimi i rezervuarit të ujësjellësit.
- Renovimi i dy fushave sportive me bar sintetik (te SHFMU "Imri Halili" dhe në Parkun e Ri).



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Vendosja e këndit të lojërave për fëmijë dhe ndriçimi i Parkut të Ri.
- Funksionalizimi i ambulancës në Gaçkë dhe renovimi i objektit të saj.
- Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit nga Gaçka deri në Greme (Lagjja Berisha).
- Ndriçimi publik në Lagjen "Bajram Curri".
- Ndriçimi publik në fshatin Burrnik dhe përgjatë rrugës kryesore.
- Ndërtimi i parkut të Gurët e Gaçkës.
- Digjitalizimi i SHFMU "Imri Halili" me Smart TV dhe pajisje moderne.
- Vendosja e kamerave të sigurisë në hyrje të Katunit.
- Ndërtimi dhe riparimi i rrethojës së shkollës.
- Hapja dhe rregullimi i kanaleve kulluese të tokave bujqësore.
- Shtrimi me zhavorr i rrugëve bujqësore.
- Largimi i ferrave dhe pastrimi i skajeve të rrugëve.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e lumit.
- Mbështetja e bujqve me subvencione komunale.
- Mbështetje për studentët e fshatrave Gaçkë dhe Burrnik.
- Vendosja e shportave për mbeturina përgjatë rrugës kryesore.

Kërkesat e fshatit Pleshinë

Kryetari i fshatit, Sabedin Mustafa, paraqiti këto kërkesa:

- Ndërtimi i një çerdheje për fëmijë në Lagjen Haziri.
- Zgjerimi i rrugës nga rrethrotullimi i ri deri te shtëpia e Isuf Hashanit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Ndërtimi i një rruge lidhëse nga Lagjja Dinolli deri te Lagjja Bajraktari.
- Asfaltimi i rrugës nga Bas Market deri te rruga "Rilindja" dhe rruga "Zeqë Rama".
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse te fusha sportive, te rruga Blini, te familja Palloshka dhe në hyrjet e tokave përgjatë rrugës kryesore.
- Trajtimi i rrugicave të parealizuara dhe përfshirja e tyre në Projektbuxhetin e vitit 2027.
- Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës që lidh Pleshinën përreth Kodrës së Sherretëve.
- Rregullimi i rrugëve bujqësore.

Kërkesat e fshatit Koshare

Sadik Qerimi paraqiti këto kërkesa:

- Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave.
- Riparimi i trotuareve.
- Ndërtimi i një çerdheje për fëmijë.
- Pastrimi i lumenjve.
- Ndërtimi i një fushe sportive.
- Rregullimi i sallës së shkollës.
- Ndërtimi i rrethojës së shkollës.
- Rregullimi i rrugëve bujqësore.

Kërkesat e fshatit Mirosalë

Zymer Berisha paraqiti këto kërkesa:

- Mirëmbajtja e rrugës Mirosalë–Rahovicë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Zllatar–Mirosalë.
- Rregullimi i trotuareve në të dy anët e rrugës.
- Ndërtimi i murit mbrojtës nga shkolla deri te Lagjja Bytyqi.
- Ndriçimi publik në lagjet Bytyqi, Dodaj dhe Cakaj, si dhe nga shkolla deri te varrezat.
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit.
- Ndërtimi i një fushe futbolli.
- Rregullimi i oborrit të shkollës.
- Rregullimi i sistemit të ujësjellësit.

Kërkesat e fshatit Mirash

Taip Bytyqi paraqiti këto kërkesa:

- Rregullimi i rrugës Babush–Mirash–Lagjja Isuf Bytyqi.
- Rregullimi i rrugës për Ferizaj nga fshati Softaj.
- Rregullimi i rrugëve bujqësore.
- Zgjidhja e çështjes së menaxhimit të mbeturinave.

Kërkesat e fshatit Varosh

Visar Heda paraqiti këto kërkesa:

- Përfundimi i rrugës kryesore.
- Rregullimi i rrjetit të kanalizimit.
- Asfaltimi i rrugicave të fshatit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Renovimi i dy fushave sportive me bar sintetik (te SHFMU "Visar Dodani" dhe në Parkun e Ri).
- Vendosja e këndit të lojërave për fëmijë dhe ndriçimi i Parkut të Ri.
- Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit në fshat.
- Ndriçimi publik në Lagjen Derguti.
- Ndërtimi i parkut në Lagjen Musa.
- Digjitalizimi i SHFMU "Visar Dodani" me Smart TV dhe pajisje moderne.
- Vendosja e kamerave të sigurisë në shkollë.
- Ndërtimi i rrethojës së shkollës.
- Hapja dhe rregullimi i kanaleve kulluese të tokave bujqësore.
- Shtrimi me zhavorr i rrugëve bujqësore.
- Largimi i ferrave dhe pastrimi i skajeve të rrugëve.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e lumit.
- Mbështetja e bujqve me subvencione komunale.
- Mbështetje për studentët e fshatit Varosh.

Kërkesat e fshatit Komogllavë

Artan Azemi paraqiti këto kërkesa:

- Asfaltimi i rrugicave në Komogllavë.
- Ndriçimi publik në disa rrugica.
- Ndërtimi i një parku për fëmijë në Lagjen "Mulla Ademi".



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Ndërtimi i trotuareve në lagjet "Nuhaj" dhe "Hajdraj", për shkak të rrezikut që paraqet mungesa e tyre për fëmijët dhe këmbësorët.

Dëgjimi publik përfundoi në orën 11:20.

Procesmbajtëse:

Shyhrete Topalli-Rexhepi

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me personelin shëndetësor dhe drejtorët/eshat e shkollave

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për vetëqeverisjen lokale, transparencën publike dhe menaxhimin e financave publike, si dhe në funksion të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, u mbajt dëgjimi publik për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2028-2029. Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit mbi orientimet kryesore buxhetore të komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në funksion të planifikimit sa më transparent, efikas dhe gjithëpërfshirës të buxhetit komunal dhe dokumenteve strategjike financiare.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe pasqyrimin të kontributit të qytetarëve përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë këtij dëgjimi, duke shërbyer njëkohësisht si mjet zyrtar i transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike. Dokumentimi i këtij procesi synon të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit të



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

evidentohen dhe të trajtohen në mënyrë të duhur gjatë fazës së përgatitjes së draft-buxhetit final dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029.

Dëgjimi publik u mbajt në kuadër të angazhimeve të Komunës së Ferizajt për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor dhe për forcimin e transparencës institucionale, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit. Përmes këtij procesi u synua identifikimi i prioriteteve zhvillimore të qytetarëve në fusha të ndryshme si infrastruktura, arsimit, shëndetësia, shërbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal, me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit.

Më **28 korrik 2026** u mbajt dëgjimi i dytë buxhetor me personelin shëndetësor dhe drejtorët/eshat e shkollave, në kuadër të procesit të hartimit të Projektbuxhetit Komunal për vitin 2027.

Të pranishëm në dëgjimin buxhetor ishin drejtoresha e Financave, **Sebahate Ajeti-Sadiku**, drejtori i Arsimit, **Afrim Llabjani**, udhëheqësja e Zyrës për Komunikim me Publikun, **Shyhrete Topalli-Rexhepi**, si dhe zyrtari komunal i Arsimit, **Evlid Ibishi**.

Në hapje të dëgjimit publik, drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, i njoftoi të pranishmit në detaje me Projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, duke theksuar se ai parasheh një rritje të lehtë krahasuar me buxhetin e këtij viti.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Nga ana tjetër, drejtori i Arsimit, Afrim Llabjani, tha se ky takim është organizuar për të dëgjuar prioritetet e dy sektorëve më të rëndësishëm të komunës, me qëllim që kërkesat dhe nevojat e tyre të trajtohen me prioritet gjatë planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit paraqitën kërkesat dhe nevojat e tyre. Shumica prej tyre kërkuar inventarizimin e objekteve, rregullimin e rrethojave, furnizimin e Qendrave të Mjekësisë Familjare me materiale shpenzuese, si dhe mbështetje për nevoja të tjera prioritare.

Nadire Imeri – Drejtoreshë e QKMF-së

- Në kuadër të projekteve kapitale, të bëhet furnizimi i Qendrave të Mjekësisë Familjare me materiale shpenzuese.
- Të bëhet furnizimi me materiale medicinale dhe pajisje të reja mjekësore, pasi ato ekzistuese janë të stërvjetruara.

Blerim Rexhepi – Drejtor i SHFMU "Konstandin Kristoforidhi"

- Të bëhet ndërtimi i sallës së edukatës fizike, ashtu siç ka qenë i paraparë në projekt.

Shqipe Zeqiri-Emini – Drejtoreshë e shkollës në Talinoc të Jerlive

- Të ndërtohet rrethoja e shkollës.
- Digjitalizimi i shkollës.
- Të ndërtohet një sallë e edukatës fizike.
- Ndërtimi i një depoje për dru gjatë dimrit.

Safete Tahiri – Drejtoreshë e shkollës në fshatin Balaj



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të bëhet një kabinet i informatikës, pasi shkolla ka 20 kompjuterë, por nuk ka hapësirë për vendosjen e tyre.

Zekir Burrniku – Drejtor i shkollës në Rakaj

- Të bëhet rregullimi i klasave dhe ndërtimi i një aneksi shkollor.

Sueda Jusufi – SHFMU "Tefik Çanga"

- Prioritet për shkollën është furnizimi me gjenerator dhe sigurimi i ngrohjes, në mënyrë që të mos përsëritet problemi i vitit të kaluar.
- Të bëhet rregullimi i tualeteve dhe zhveshtoreve në sallën e edukatës fizike, pasi ajo shfrytëzohet edhe nga klubet sportive. Për shkak të mosfunksionimit të tyre përdoren tualetet e shkollës, të cilat janë në gjendje të rënduar.
- Të bëhet rregullimi i oborrit dhe ndërtimi i rrethojës së shkollës.

Selim Bega – Kryeinfermier në QKMF

- Të vendosen ulëse për pacientët në tetë Qendra të Mjekësisë Familjare.
- Të sigurohen uniforma për stafin.

Arben Aliu – Drejtor i SHFMU "Vezir Jashari"

- Të bëhet ngjyrosja e shkollës.
- Të ndërtohet një sallë e edukatës fizike.

Bekim Ndrecaj – Drejtor i SHFMU "Naim Frashëri", Zaskok

- Të ndërtohet një rrethojë metalike te fusha sportive, pasi ajo ndodhet afër rrugës.
- Të ndërtohet një depo për dru.
- Të sigurohen materiale higjienike për shkollën.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Zejnepe Salihu – Drejtoreshë e SHFMU "Ismail Qemali", Prelez i Jerlive

- Rregullimi i tualeteve të shkollës është nevojë urgjente.
- Të ndërtohet një aneks shkollor.

Mihrije Blakaj – Drejtoreshë e SHFMU "Kemajl Hetemi", Rahovicë

- Të ndërtohet një kabinet për lëndët shkencore.
- Të ndërtohet një aneks shkollor.
- Të zgjidhet problemi i mungesës së ujit.
- Të ndërtohet një sallë sportive.

Mirsad Dërguti – Drejtor i SHFMU "Visar Dodani", Varosh

- Rregullimi i tualeteve, të cilat janë në gjendje emergjente.
- Zëvendësimi ose riparimi i kaldajës së dëmtuar.
- Ndërtimi i rrethojës së shkollës.
- Inventari i shkollës është shumë i dëmtuar dhe duhet të zëvendësohet.

Sylejman Haxha – Drejtor i SHFMU "Mic Sokoli"

- Të ndërtohet rrethoja e shkollës.
- Zgjerimi i sallës së arsimtarëve dhe zyrës së drejtorit.
- Rregullimi i tualeteve.
- Vendosja e kamerave të sigurisë.
- Gëlqerosja e dhomave të mësimi.
- Rregullimi i dritareve.
- Të ndërtohet një sallë e edukatës fizike.

Ky dëgjim buxhetor përfundoi në orën **11:40**.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesmbajtëse

Shyhte Topalli-Rexhepi

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor për buxhetimin gjinor me përfaqësues/e të OJQ-ve, të rinjve/rejave, pensionistëve/eve, fermerëve/eve dhe përfaqësuesve/eve të bizneseve

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për vetëqeverisjen lokale, transparencën publike dhe menaxhimin e financave publike, si dhe në funksion të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, u mbajt dëgjimi publik për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2028-2029. Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit mbi orientimet kryesore buxhetore të komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në funksion të planifikimit sa më transparent, efikas dhe gjithëpërfshirës të buxhetit komunal dhe dokumenteve strategjike financiare.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe pasqyrimin të kontributit të qytetarëve përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë këtij dëgjimi, duke shërbyer njëkohësisht si mjet zyrtar i transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike. Dokumentimi i këtij procesi synon të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit të evidentohen dhe të trajtohen në mënyrë të duhur gjatë fazës së përgatitjes së draft-buxhetit final dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Dëgjimi publik u mbajt në kuadër të angazhimeve të Komunës së Ferizajt për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor dhe për forcimin e transparencës institucionale, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit. Përmes këtij procesi u synua identifikimi i prioriteteve zhvillimore të qytetarëve në fusha të ndryshme si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal, me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit.

Më 29 korrik 2026 u mbajt dëgjimi buxhetor në kuadër të procesit të hartimit të Projektbuxhetit Komunal për vitin 2027, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, grupeve të grave, të rinjve, pensionistëve, fermerëve dhe bizneseve.

Të pranishëm në këtë dëgjim buxhetor ishin drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, drejtori i Bujqësisë, Burim Bajrami, drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Balton Dërguti, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Dr. Kemajl Emini, si dhe udhëheqësja e Zyrës për Komunikim me Publikun, Shyhrete Topalli-Rexhepi.

Në hapje të dëgjimit, drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, i njoftoi të pranishmit në detaje me Projektbuxhetin për vitin 2027, duke theksuar se ai parasheh një rritje të lehtë krahasuar me buxhetin e këtij viti. Ajo bëri të ditur se buxheti i planifikuar për vitin 2027 arrin vlerën totale prej **56,102,329 euro**. Nga kjo shumë, **15.2 milionë euro** janë paraparë për investime kapitale, rreth **2.88 milionë euro** për subvencione, **1.45 milionë euro** për shpenzime komunale, **12.05 milionë euro** për mallra dhe shërbime, ndërsa **24.51 milionë euro** për paga dhe mëditje.

Pas prezantimit të Projektbuxhetit, fjala iu dha të pranishmëve, të cilët paraqitën nevojat, kërkesat dhe propozimet e tyre për Projektbuxhetin e vitit 2027.

Dashurije Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Të krijohen sa më shumë hapësira për të rinjtë, të pajisura edhe me mjete të vogla sportive?
- A mund të funksionalizohet Qendra Rinore me shërbime 24-orëshe?
- A mund të organizohen trajnime për ngritjen e kapaciteteve të grave në hartimin dhe shkrimin e projekteve?

Sabit Azizi – qytetar

- Pse ka pritje shumë të gjata në Qendrën e Mjekësisë Familjare në rrugën e Gjilanit?

Gresa Behluli – Down Syndrome Kosova, Ferizaj

- A është paraparë buxhet për shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara?

Hajriz Shabani – qytetar

- A mund të ndërtohet një park për fëmijë në rrugën e Varoshit dhe të krijohen shtigje për ecje për pensionistët?
- Të zgjidhet çështja e ujësjellësit në rrugën e Varoshit.
- Të sanohen rrugët e dëmtuara në lagjet e qytetit.

Elmedina Gashi – Hendifer

- A keni planifikuar ndarjen e një linje të veçantë buxhetore për personat me aftësi të kufizuara?
- A ekziston mundësia të sigurohet një ambient i përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta?

Rafete Rexhepi-Haziri – pensioniste

- Deri ku kanë arritur punimet për ndërtimin e Qendrës për Pensionistë?



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Aolta Bajrami – Këshilli Rinor

- Çfarë është planifikuar për rikonstruktimin e Qendrës Rinore?
- A do të ketë thirrje publike për të rinjtë?

Kadri Shefkiu – pensionist

- A do të vazhdojë rregullimi i trotuarit në rrugën "Rizah Matoshi", nga shkolla e tutje, për shkak të rrezikut të madh për nxënësit?
- Çfarë masash do të ndërmerren për zgjidhjen e problemit me qentë endacakë, të cilët janë të shumtë në qytet?

Dëgjimi buxhetor përfundoi në orën **11:50**.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi